



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.221/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, në Zgjedhjet Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.221/2025 e datës 15.10.2025 e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12.10.2025.

A r s y e t i m

Më datë 15.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.221/2025, të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, në të cilën pretendon se më datë 14 Tetor 2025, komisionerët e LVV kanë evidentuar një dukuri të pazakontë që cenon drejtpërdrejt në fshehtësinë dhe vullnetin e lirë të votuesve. Në shumë vendvotime të komunës së Hani i Elezit është regjistruar një numër jashtëzakonisht i lartë i rasteve të votimit më asistencë, përfshirë persona të rinj, të arsimuar dhe pa asnjë arsye të ligjshme për të kërkuar ndihmë gjatë votimit. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se sipas librave zyrtarë të votimit të dorëzuar në Qendrën Komunale të Numërimit, janë regjistruar mbi 312 raste të votimit më asistencë, shifër kjo që kalon çdo mesatare normale, marrë parasysh numrin total prej 4,961 votuesve, e cila përfaqëson mbi 6% të të gjithë votuesve që kanë votuar. Në një proces normal zgjedhor, përqindja e votuesve që kërkojnë asistim(për shkak të paaftësisë fizike apo verbërisë) nuk kalon 1%. Sipas parashtruesit të ankesës këto shifra përbëjnë tregues serioz të organizimit të qëllimshëm për të ndikuar në vullnetin e votuesve dhe se analiza e librave tregon se mbi 60% të rasteve është shënuar “nuk sheh”, ndërsa 30% “nuk di shkrim e lexim”- shprehje të përsëritura në çdo faqe dhe është indicie se arsyetimet janë shënuar për formalitet dhe nuk

janë reale dhe nuk ka arsye tjetër të besueshme. Kjo dukuri përbën shkelje të drejtpërdrejt të nenit 10 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 për Votimin, Numërimin dhe Menaxhimin e Vendvotimit, i cili garanton se votuesi plotëson fletëvotimin vetëm, ne fshehtësi, pa praninë e askujt tjetër. Në ankesë, ankuesi pretendon gjithashtu se në librat e votimit të dorëzuar për Hani i Elezit vërehet se disa persona kanë asistuar një numër të madh votuesish, ne disa raste dhjetëra herë brenda të njëjtit vendvotim, emra të njëjtë që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme në faqe të ndryshme të librave, me shkrim dhe nënshkrim identik, çka tregon se asistimi nuk është bërë për raste te veçanta, por në mënyrë të organizuar. Këto shkelje janë të përsëritura, sistematike dhe prima facie duke u toleruar nga vetë komisionerët e vendvotimeve në kundërshtim me përgjegjësitë e tyre të parapara me nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024. Diferenca mes dy kandidatëve është vetëm 93 vota, ndërsa numri i votuesve me asistencë arrin në së paku 312 raste më shumë se trefishi i diferencës ndërmjet kandidatëve, dukuria paraqet ndikim të drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Sipas nenit 106 par.2 dhe nenit 120 par.1 pika 1.2 të LZP-së, përsëritja e votimit urdhërohet në rastet kur parregullsitë e konstatuara kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Andaj, duke marrë parasysh këto rrethana, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP të hetojë rastet e asistimeve të panevojshme të regjistruara gjatë ditës së votimit më 12 Tetor 2025, verifikojë librat e votimit të dorëzuar në Qendrën Komonale të Numërimit në Han të Elezit për të identifikuar vendvotimet me numër jo të zakonshëm të asistimeve dhe sipas rezultatit të hetimeve dhe verifikimit, t'i rekomandojë KQZ-së përsëritje të votimit në Han të Elezit. Si dëshmi ka bashkangjitur, si fotografi të Librit të Votimit me Asistencë.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja thekson se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e parashtruar, sqaron se, bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.12/2024 për Votimin, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5,6,7 dhe 8 përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 15.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të komunës së Hanit të Elezit nga i cili ka marrë sqarim si në vijim: KKZ, në Hani i Elezit ka deklaruar pas shqyrtimit të ankesës dhe të dokumentacionit të bashkangjitur si foto të bëra të Librit Votues në vendvotim, KKZ njofton se për të gjithë anëtarët e Këshillave të Vendvotimit është mbajtur trajnim për procedurat e votimit sipas rregullave zgjedhore të KQZ-së po ashtu janë trajnuar edhe për procedurat e votimit me asistencë ku është kërkuar që të zbatohen procedurat sipas përgjegjësisë që i kanë anëtarët e këshillave të vendvotimit sipas nenit 9,10 të rregullës zgjedhore nr.11/2024. Gjithashtu, KKZ sqaron se vizitat e herëpashershme në ditën e zgjedhjeve gjatë procesit të votimit dhe numërimit KKZ në Hani i Elezit nuk ka vërejtur parregullsi të theksuara që kanë mundur të minojnë bazën ligjore të lartcekur, lirinë e shprehjes dhe fshehtësinë e votës. Nëse pretendohet se ka qenë numri i madh i votuesve me asistencë në disa vendvotime përgjegjës kryesor sipas nenit 10.8 të rregullës zgjedhore nr.12/24 është kryesuesi dhe anëtarët e KVV, ku thuhet se: kryesuesi dhe anëtarët sigurohen që të parandalojnë keqpërdorimin apo tentimin për keqpërdorim të së drejtës për votim me asistencë. Komisioni verifikoi librat e votimit me asistencë që iu kanë bashkangjitur si provë dhe konstatoi se këto foto janë bërë pikërisht

nga kryesuesit e vendvotimit të këtij subjekti politik ankues, ku Libri i Votimit me asistencë përmban emra, numra personal dhe nënshkrime të votuesve. Andaj, çdo fotografim apo shpërndarje e atyre të dhënave (ligji për mbrojtjen e të dhënave personale). Në vendvotim ka qenë poster i vendosur që ndalohet fotografimi. KVV dhe Vëzhguesit lejohen vetëm ta shikojnë librin për verifikim por jo ta fotografojnë, kopjojnë apo ta shpërndajnë pa autorizim. Sipas fotove të bëra librit shihet qartë se shumë foto janë të njëjtë libër (emra të njëjtë si asistues dhe i asistuari). Asistimi nuk është dukuri e pazakontë, me fakt është dukuri e zakonshme, në çdo cikël zgjedhor që nga pas lufta, Kosova ka pasur asistim gjatë votimit atë e dallon që ka trend në rënie apo ndoshta numër më të vogël se të gjitha ciklet tjera zgjedhore. Andaj, KKZ siguron që procesi zgjedhor i mbajtur me 12 Tetor 2025 ka qenë i rregullt dhe transparent i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike edhe të atyre ndërkombëtare dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë të vetme. Gjithashtu, KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Hanit të Elezit, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë. Bashkangjitur përgjigja e KKZ-së në Han të Elezit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 15.10.2025, ku ka pretenduar se më datë 14 Tetor 2025, komisionerët e LVV kanë evidentuar një dukuri ku në shumë vendvotime të komunës së Hani të Elezit është regjistruar një numër jashtëzakonisht i lartë i rasteve të votimit me asistencë, përfshirë persona të rinj, të arsimuar dhe pa asnjë arsye të ligjshme për të kërkuar ndihmë gjatë votimit.

Me dispozitën e nenit 102 paragrafi 5 i LZP-së, parashihet që: “KQZ bën përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve.”

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh që: “*Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj*”, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili parasheh që: “*PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*”

Neni 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.18, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“Personi mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve ankesë për shkeljet e pretenduara në ditën e votimit , nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”*

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndë ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, dhe nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.18, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48)orëve ankesë për shkeljet e pretenduara në ditën e votimit, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 15.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.


Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.221/2025 më datën 17.10.2025

Kryesuese e panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.95/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Faton Bajrami dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega Hani i Elezit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.221/2025, të datës 17.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 23.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega Hani i Elezit, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.221/2025, të datës 17.10.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.221/2025, të datës 17.10.2025, është vendosur: Hedhet e pasafatshme ankesa ZL.Anr.221/2025 datë 15.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Hani i Elezit lidhur me parregullsitë ditën e votimit që sipas pretenduesit cenon drejtpërdrejt fshehtësinë dhe vullnetin e lirë të votuesve.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega Hani i Elezit, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Apropojë ankesën e parashtruar pranë kësaj gjykate, të anulojë Vendimin e PZAP-së ZL.Anr.221/2025 si të pabazuar, të urdhërojë hetimin



e drejtpërdrejt të librave origjinal të votimit për Komunën e Hanit të Elezit, të ruajtur në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), të konstatojë se numri i lartë i rasteve të asistimit përbën shkelje të nenit 10 të Rregullores 12/2024 dhe të parimit të fshehtësisë së votës, të konstatojë se PZP ka shkelur të drejtën për mjet efektiv juridik dhe proces të drejtë dhe të Urdhërojë përsëritjen e votimit aty ku shkeljet janë të verifikueshme dhe ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ankesën e datës 20.10.2025, nga ankuesi subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZL.Anr.221/2025 të datës 17.10.2025 të Refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se më datë 15.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.221/2025, nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega Hani i Elezit në lidhje me parregullsitë ditën e votimit që i referohen asistimit të votuesve, e që më këtë sipas ankuesit janë bërë shkelje pasi është cenuar fshehtësia e votimit, ndërsa po ashtu sipas ankuesit, ankuesi ka marrë informata për këtë çështje nga QKN (Qendra Komunal e Numërimit) ku dhe ka dorëzuar fotografi të librave të votimit me emrat e personave votues dhe në pjesën anësore me konstatimin pse është lejuar asistimi.

Ankuesi më tutje shton se numri i votuesve me asistencë është 312 raste, që tejkalon çdo mesatare normale, marrë parasysh numrin total prej 4,961 votuesve, pra është shifra mbi 6 % e të gjithë votues, duke shtuar tutje se në një proces normal zgjedhor përqindja e votuesve që kërkojnë asistim nuk kalon 15.

Ankuesi më tutje shton se 60 % e arsye për votim me asistim është “ nuk shih” dhe rreth 30 % “nuk dinë shkrim lexim”, dhe se këto janë formalitete por nuk janë reale.



Kjo sipas ankuesit përbën shkelje të drejtpërdrejt të nenit 10 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 për Votimin, Numërimin dhe Menaxhimin e Vendvotimit, i cili garanton se votuesi plotëson fletëvotimin vetëm në fshehtësi, pa praninë e askujt tjetër. Ankuesi pretendon se disa persona kanë asistuar një numër të madh votuesish në disa raste dhjetëra herë brenda të njëjtit vendvotim.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 16.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: Komisioni Komunal i Zgjedhjeve i ka trajnuar të gjithë anëtarët e Këshillave të Vendvotimit si dhe janë trajnuar edhe për procedurat e votimit me asistencë ku është kërkuar që të zbatohen procedurat sipas përgjegjësisë që i kanë anëtarët e këshillave të vendvotimit sipas nenit 9,10 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2024. Po ashtu Komisioni Qendror Zgjedhor njofton se Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), gjatë vizitave të herëpashershme nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi që ka mundur ta minojë bazën ligjore të cekur të lartcekur. Në raport me numrin e madh të votuesve me asistencë në disa vendvotime përgjegjës është kryesuesi dhe anëtarët e KVV-së, pasi kryesuesi dhe anëtarët sigurohen që të parandalojnë keqpërdorimin apo tentimin për keqpërdorim të së drejtës për votim me asistencë. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve i ka verifikuar librat e votimit me asistencë që iu kanë bashkangjitur si provë dhe ka konstatuar se këto foto të bëra librit votues janë bërë pikërisht nga kryesuesit e vendvotimit të këtij subjekti politik ankues. Më tutje thekson se çdo fotografim, apo shpërndarje e atyre të dhënave përbën shkelje të fshehtësisë së votës dhe të dhënave sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Krejt në fund shton se si Komision Komunal sigurojnë që procesi zgjedhor i mbajtur me datë 12.10.2025 ka qenë i rregullt dhe transparent i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim. I kanë rekomanduar PZAP që ta refuzon ankesën, përgjigje e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e subjekteve politike brenda Komisionit Komunal Zgjedhor.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në tërësi e kundërshton ankesën e paraqitur kundër vendimit ZL.Anr.221/2025, të datës 17.10.2025, duke shtuar se mbeten në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Nga shikimi i shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 15.10.2025 ku ka pretenduar se me datë 14.10.2025 komisionerët e LVV-së kanë



evidentuar një dukuri u në shumë vendvotime të Komunës së Hanit të Elezit është regjistruar një numër jashtëzakonisht i lartë i rasteve të votimit me asistencë, përfshirë persona të rinj, të arsimuar dhe pas asnjë arsye të ligjshme për të kërkuar ndihmë gjatë votimit.

Me dispozitën e nenit 102 paragrafi 5 i LZP-së parashihet që: *“KQZ bënë përmbledhjen e rezultateve preliminare të vendvotimeve dhe i bënë publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve”*.

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së parasheh që: *“ Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilat janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrijë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë orëve nga parashtrimi i saj”* si dhe neni 13 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosije së Ankesave të PZAP-it i cili parasheh: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Neni 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it i cili përcakton se: *“Personi mund të paraqes në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve ankesë për shkeljet e pretenduara në ditën e votimit, nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”*.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë Dega Hani i Elezit.

Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 15.10.2025, ndërsa zgjedhjet janë mbajtur me 12.10.2025 dhe se Qendra e Votimit është



mbyllur në ora 19:00 të datës 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit ligjor të paraparë me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së.

Me nenin 23 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet se: *“Kreu XIII (Qendrat e votimit dhe votimi), dhe çfarëdo dispozite e ndërlidhur me këtë çështje, e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mutatis mutandis vlejnë për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.”*


Me nenin 28 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Kreu XX (Komisioni zgjedhor për ankesa dhe parashtrësia), dhe çfarëdo dispozite e ndërlidhur me këtë çështje, e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mutatis mutandis vlejnë për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.”*

Me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”.*

Me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohet se: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve ankesë për shkeljet e pretenduara ditën e votimit, nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”*

Me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, me të cilën përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatit e paraparë ligjor”.*

Prandaj nga kjo rrjedhë se vendimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.



Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës janë pretendime që i referohen aspekteve meritore të cilat PZAP-i nuk i ka vlerësuar me të drejtë, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë, dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pa afatshme, PZAP-i e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje të ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Afatet ligjore apo të parashikuara me akte nënligjore janë garanci për palën ankuese dhe detyrime për organet përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave brenda afatit kohor, ndërsa veçanërisht afatshmëria e ankesave në procesin zgjedhor është jetike për tu përmbyllur si i tillë dhe mos të ketë prolongime kohore.

Pretendimet e subjektit ankues se afati i ankesës në rastin konkret duhet të vlejë nga momenti i njoftimit dhe meqenëse subjekti ankues është njoftuar me datë 14.10.2025 nuk qëndron sepse Ligji për Zgjedhjet por edhe Rregulloret përkatëse që i referohen procesit zgjedhor kanë paraparë afate të ndryshme gjatë një procesi zgjedhor, mirëpo në momentin që parregullsia i referohet ditës së votimit vlen vetëm një afat dhe ai afat është afati të cilin e ka marrë për bazë PZAP-i, pra dyzetë e tetë (48) orë nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe nuk mund të aplikohet asnjë afat tjetër.

Vendimi i PZAP-it sipas Gjykatës Supreme të Kosovës në asnjë formë nuk e cenon nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 13 të KEDNJ-së e as nenin 2 paragrafi 3 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, sepse subjekteve politike dhe të gjithë qytetarëve i garantohet e drejta në ankesë, sikurse në rastin konkret subjekti ankues e ka pasur në dispozicion afatin dyzet e tetë (48) orë dhe PZAP-i nuk ia ka mohuar këtë afat, por mos shfrytëzimi i afatit nga ana e subjektit ankues nuk mund të parafrzohet si cenim i të drejtës së mjetit juridike, ankimit apo procesit të drejtë. Sipas Gjykatës Supreme sikur një ankesë e tillë apo secila ankesë tjetër të shqyrtohej në meritë apo përmbajtje edhe në rastet kur është e pa afatshme do të përbënte cenim të sigurisë juridike dhe do të kishim prolongim të ciklit të procesit zgjedhor.



Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.95/2025 me datë 23.10.2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćení radnik
